

HULUMTIM- DIVORCET FORMALE NË MAQEDONI

AMBASADA GJERMANE: RËNDË TË JEPEN TË DHËNA PËR KURRORËZIMET FIKTIVE

Programi kompjuterik për statistikë, sipas tyre, "nuk i ndan ata që kanë nxjerur viza për kurrorëzime", ashtuqë numri i përgjithshëm i vizave nga ajo kategori sillet në 1.300 për vitin 2008 (këtu bëjnë pjesë edhe studentët, bebi-siter dhe tjerë). "Sa i përket çështjes për kurrorëzime fiktive, assesi nuk mund të jepet përgjigjigje dhe kjo është e tërrë ajo me të cilën disponojmë", thonë në ambasadën gjermane në Shkup

FAMI BAJRAMI

Në Ambasadën gjermane, disponojnë më të dhëna se në vitin 2008, janë miratuar në përgjithësi rreth 1.300 viza me leje qëndrimi prej 90 ditësh. Numri më i madh i këtyre vizave janë të ashtuquajtura "viza familjare", por ata përfshijnë edhe ata viza për fëmijë të cilët shkojnë te prindërit e tyre që veçmë jetojnë në Gjermani", thonë në ambasadën gjermane në Shkup.

Programi kompjuterik për statistikë, sipas tyre, "nuk i ndan ata që kanë nxjerur viza për kurrorëzime", ashtuqë numri i përgjithshëm i vizave nga ajo kategori sillet në 1.300 për vitin 2008 (këtu bëjnë pjesë edhe studentët, bebi-siter dhe tjerë)".

"Sa i përket çështjes për kurrorëzime fiktive, assesi nuk mund të jepet përgjigjigje dhe kjo është e tërrë ajo me të cilën disponojmë", thonë në ambasadën gjermane në Shkup.

Komunat shqiptare, kampion për shkurorëzime

Shkurorëzimet të shqiptarët e Maqedonisë, apo martesat për letra kurbeti, shënojnë një rritje të vazhdueshme. Nga të dhënat statistikore, komunat me shumicë shqiptare, kryesojnë në listën e shkurorëzimeve. Në vitin 2006, në Maqedoni kanë ndodhur gjithsej 1.474 shkurorëzime, nga të cilat në 465 vetëm në komunat me shumicë shqiptare, që përbën 30 për qind të numrit të përgjithshëm të



ndarjeve. Kampion është Gostivari me 101 shkurorëzime, pastaj pason Çairi me 83, Tetova me 72, Vrapçishta me 28, Bogovina me 27, Zhelina dhe Struga me nga 21, Dibra me 20, Tearca me 19, Bërvenica me 16, Likova dhe Studeniçani me nga 13, Haraçina me 8 dhe Oslomej e Zajazi me nga 6 shkurorëzime gjatë vitit të kaluar.

Nëse këto numra krahasohen me numrin e banorëve të komunave të përmendura, rezultoni se Vrapçishti ka 3 shkurorëzime në një mijë banorë, Gostivari 2, Tetova 1.02, Çairi 1.21, Bogovina 1.86, dhe komunat tjera me afër një divorc.

Në Entin shtetëror të statistikës (ESH), thonë se në nivel të shtetit vitit 2006, ka shënuar rritje numri i kurorëzimeve derisa është zvogëluar numri i kurorëzimeve. Sipas tyre, numri më i madh martesave bëhen gjatë tri muajve të verës (qershor, korrik dhe gusht), kur numri i divorceve është në minimum. Derisa, në muajt e dimrit bie numri i martesave dhe rritet ai i shkurorëzimeve. Kjo është shënuar në muajt e parë të vitit të kaluar, kur janë rregjistruar 4.8 për qind më pak martesave se në tri muajt paraprak, derisa numri i divorceve ka arritur shifrën në 354.

Në dhjetë vitet e fundit, sipas ESH-së, është rritur numri i kurorave të vëna ndërsa është zvogëluar numri i divorceve. Vitin e kaluar janë lidhur 14.908 kurorë, që paraqet një rritje prej 2.8 për qind në krahasim me vitin

2005, ndërsa divorcet janë zvogëluar për 1.65 për qind.

Statistikat tregojnë se 92.3 për qind e femrave për herë të parë kanë vënë kurorë kurse te burrat-9.3 për qind, lidhin martesën për së dyti herë.

Sipas të dhënave zyrtare deri te të cilat arriti, në rajonin e Tetovës janë regjistruar 791 kurorëzime, prej të cilëve 84 janë me shtetase të huaj. Shumica nga ata që kanë lidhur kurorë me shtetase të huaj janë shqiptarë, ndërsa nusët i kanë nga Gjermania, Shqipëria, Kroacia, Zvicra, Sllovakia, Bullgaria, Belgjika, Danimarka, Holanda, Austria, Franca apo Norvegjia.

Në rajonin e Tetovës, në vitin 2005, ka pasur gjithsej 552 kurorëzime, prej të cilave 56 me shtetase të huaj. Këto kurorëzime thuhet të jenë bërë nëpërmjet ambasadave të vendeve përkatëse.

Në vitin 2004, janë regjistruar 453 kurorëzime, prej të cilave 69 janë me të huaj.

Gjatë vitit 2003, ka pasur 83 martesave, ku 24 kanë qenë me të huaj, kryesisht nga Gjermania, ndërsa janë regjistruar 24 shkurorëzime. Në Komunën e Zhelinës, prej 31 martesave me të huaj, 24 janë me shtetas gjermane, kryesisht me femra.

Qeveria shikon zgjidhjen në liberalizimin e vizave

Qeveria e Maqedonisë, nuk ka ndonjë plan se si t'ia bëjë me këtë çështje, por e vetmja rrugëdalje sipas tyre në tërësi këtë gjendje, "është liberalizimi i

vizave me shtetet e Bashkimit Evropian (BE)".

"Kjo çështje mendoj të ndalet me liberalizimin e vizave. Pra, atëherë mendoj se 90 për qind e rasteve të këtylla të zvogëlohen, dhe të mos paraqiten raste që qytetarët, veçmas ata shqiptarë, të martohen me shtetase evropiane", thotë zëdhënësi i qeverisë së Maqedonisë Shefik Duraku.

Sipas tij, madje ka shpresa që deri ka muaji prill i këtij viti, Komisioni Evropian (KE), të sjellë një vendim të favorshëm, për çështjen e vizave me Maqedoninë, dhe nëse ndodh kjo pastaj është faza tjetër e ratifikimit nga ana e Parlamentit të BE-së dhe që në fund pastaj të bëhet e plotfuqishme.

"Deri në fund të vitit 2009, sjellja e vendimit të KE-së, ratifikohet në gjitha shtetet anëtare të BE-së, dhe janë shpresat që në fillim të vitit 2010, qytetarët e Maqedonisë të udhëtojnë pa viza. Por, them se gjithçka do lidhet edhe me zgjedhjet e 22 marsit. Pra një vendim i këtillë tani është direkt i lidhur me zgjedhjet, dhe nëse është pozitive, është e sigurtë se do të ketë liberalizim të vizave", tha Duraku.

Sipas tij, është e evidente gjendja, se Maqedonia kushtet rreth çështjeve teknike i plotëson, pra, është fjala se Qendra për mbikqyrje kufitare përmes kamerave vëzhgon çdo kalim kufitar me shtetet fqinje, pastaj pasaportat biometrike, që janë edhe një arsye tjetër që nuk paraqet rrezik për politikën migruese të BE-së.

"Madje, Maqedonia ka një kriter pozitiv me pasaportat e humbura, ku përqindja nuk është e madhe, dhe kjo është një argument i sigurtë se nuk bëhet keqpërdorim me ta dhe i plotëson këtë kushtet. Pastaj, numri i qytetarëve që kanë qëndrim të parregulluar nuk është ndonjë problem i madh për politikën migruese në BE, dhe gjitha këto janë pametra pozitive rreth liberalizimit të vizave", tha zëdhënësi qeverisë Shefik Duraku. (vazhdon)

(Kjo storje hulumtuese mbështetet nga Asociacioni danez për gazetari hulumtuese SCOOP që vepron edhe në Maqedoni)



KANDIDATI I VMRO-së, TRAJANOVSKI

Premton trafik të sigurtë

Kandidati për kryetar të qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, që është nga radhët e VMRO-DPMNE-së ka shpallur të hapur shtabin zgjedhor në qendër të qytetit.

Sipas Trajanovskit shtabi do të jetë i hapur në çdo kohë për qytetarët të cilët në çdo kohë do të mund të japin sugjerimet dhe propozimet e tyre se si duhet të duket kryeqyteti i Maqedonisë. Ai theksoi vetëm një segment të programit të tij, e ai është, "projekti për kalime këmbësorike nëntokësore me qëllim që të kemi komunikacion më të sigurtë për qytetarët dhe këmbësorët".

"Ai kalim nëntokësor këmbësorik do të jetë në rrugën Maqedonia. Ai do të ndërtohet në bazë komercialesepse do të ketë dyqane të ndryshme", tha Trajanovski.

PDSH-JA REAGON

Të respektohet fushata pa flamuj

Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), ka reaguar të martën ndaj një skandali që ndodhi në Radion Maqedonase, ku me datë 27 shkurt 2009 kandidata e PDSH-së për president shteti Mirushe Hoxha bëri një inçizim për këtë radio, mirëpo tani nga kjo radio tregojnë se ai material është humbur rastësisht.

"Ne asesi nuk besojmë në këtë rastësi. Si është e mundur që një radio që e quna veten serioze të humb materialet për një kandidat për president shteti.

E gjithë kjo është bërë me qëllim që dëgjuetit mos të jenë të njoftuar me platformën dhe programin jo vetëm të Mirushe Hoxhës, por edhe PDSH-së", tha Sheval Memishi nga PDSH-ja.

"Kërkojmë nga kjo radio që publikisht t'i kërkojë falje znj. Mirushe Hoxha. Madje, i gjithë opinioni ishin dëshmitarë se në rrugët dhe vendet publike të Gostivarit ishin të stërbushura me material propagandistik të BDI-së. Pra, edhe përkundër apelit të PDSH-së që nëpër rrugë dhe vende publike të mos ketë flamuj dhe material tjetër propagandistik, BDI-ja nuk e respekton këtë marrëveshje. Ne nuk jemi befasuar me këtë veprim të tyre edhe pse BDI-ja u pajtua që të mbështesin këtë ide, ata asnjëherë nuk e kanë mbajtur fjalën", thonë në këtë parti. Ndryshe, nga kjo parti edhe një herë kanë apeluar te gjithë partitë që të mbështesin idenë e tyre dhe të kontribuojmë për zgjedhje të qeta, të lira dhe demokratike.

3 MARS, DITA E KOMUNËS SË TETOVËS

Tetova ka perspektivë

Komuna e Tetovës ka festuar të martën 3 marsin, ditën e komunës. Me këtë rast kreu i saj Hazbi Lika tha se kjo ditë përbën një moment të rëndësishëm sepse qytetarëve tani u jepet mundësia që nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur me votën e lirë të përfaqësojnë interesat e tyre.

"Sistemi e ri që po vendosej në këto hapësira na mundësoi që mendimet tona të shfaqnim në mënyrë të hapur, ndërsa po kalonim të mbeturat dhe pasojat e sistemit të sapokaluar i cili

ushtrohej për dekada të tëra. Edhe pse u shenuan ditët të para të demokracisë dhe se ato u mirëpritën nga qytetarët e saj ne u ballafaquam me një tranzicion i cili zgjati më shumë se sa që pritej. Qytetarët në përgjithësi menduan se me ardhjen e demokracisë do të zgjidhen të gjitha çështjet mirëpo koha e dëshmoi të kundërtën sepse përkushtimi ndaj zhvillimit dhe ngritjes së procesit të demokracisë deri në shkallë të pranueshme për të gjithë nuk ka qenë sa duhet", tha Hazbi Lika. "Jam i



vetëdijshëm se katër vite janë ndoshta pak për kurorëzimin e një procesi kaq të rëndësishëm për ta bërë Tetovën qytet modern, ashtu si gjithë qytetet e tjera në vendeve të rajonit. Por shpresoj se me mbështetjen e qytetarëve, të pushtetit lokal, të ndërkombëtarëve dhe të institucioneve të tjera, Tetova

do të bëhet një metropol i vërtetë. Për këtë ekzistojnë të gjitha premiset sepse është një qytet me dy universitete, me teatër, me galeri të arteve, me bibliotekë kombëtare, me zhvillim ekonomik lokal. Thënë shkurt, ka një perspektivë të sigurt dhe të qëndrueshme për të ardhmen", tha më tej Lika.

Ndryshe, me rastin e 3 marsit-ditës së Komunës së Tetovës, u ndanë dhurata dhe mirënjohje personave fizikë e juridikë në shenjë mirënjohjeje të komunës së Tetovës për rezultatet e tyre të arritura në fushëveprimet e ndryshme të punës e të jetës, që paraqesin kontribut të veçantë në afirmimin e qytetit të Tetovës.